



Va

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**  
**DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: [www.hidaa.gov.al](http://www.hidaa.gov.al), E-mail: [info@hidaa.gov.al](mailto:info@hidaa.gov.al)

Nr. Indeksi  
në ILDKPKI  
dhe Vit **2021**

**DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE**  
**PARA FILLIMIT TË DETYRËS**

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklarim të interesave private të tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet e pasqyruara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, Ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, me Ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012, Ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014 dhe Ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017.

**A U T O R I Z I M**  
**PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE**

Emri	Atësia	Mbiemri
<b>Flutura</b>	<b>Abdurrahman</b>	<b>Açka</b>
Funksioni		
<b>Deputete</b>		
Institucioni dhe adresa		
<b>Kuvendi i Shqipërisë</b>		
Data e emërimit në detyrë	Data e dorëzimit të deklaratës	
<b>10.09.2021</b>	<b>09.10.2021</b>	

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

**A u t o r i z o j:**

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

**Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.**

Nënshkrimi i subjektit deklarues



**DEKLARIMI I PASURIVE  
DHE  
BURIMI I KRIJIMIT**

**Objekti i deklarimit:** Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në datën e fillimit të detyrës, sipas gërmës a, b, c, ç, d \* të nenit 4 dhe nenit 4/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil, të ndodhura brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të zotëruara nga zyrtari, apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë.

**Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë të shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.**

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
1.	Apartament banimi, me sipërfaqe 106 m <sup>2</sup> , në adresën Rr. [redacted] Tiranë. Në pronësi bashkë me bashkëshortin Blerë me kontratë sipërmarrjeje Nr. [redacted] Rep. dhe Nr. [redacted] Kol., dt. 02.05.2002, nga Shoqëria [redacted] Blerë me kredi të marrë nga [redacted] Bank, The Netherlands, datë 14.04.2002.	45000 USD (Dyzet e pesë mijë dollarë)	50%
2.	Apartament banimi, me sipërfaqen 78 m <sup>2</sup> në adresën [redacted] The Netherlands. Në pronësi të bashkëshortit dhe sipas ligjeve holandeze me të drejtë të gjysmëpronësisë mbi të. Blerë me kredi të marrë në vitin 1977, kredi e shlyer prej vitësh.	220000 (Dyqind e njëzet mijë) Euro	50%
3.	Autoveturë Skoda 5L Yeti, blerë me leasing nga [redacted] me kohë shlyerje 5 vjet, me kontratën Nr. [redacted] Rep. dhe Nr. [redacted] Kol., datë 18.05.2016. Pagesë e përfunduar dhe në pronësi personale.	3293682 (Tre milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy) lekë	100 %
4.	Skanderbeg Books sh.p.k., themeluar më datë 13.03.2001, me kapital fillestar 100000 (njëqind mijë) lekë, me vendim të Gjykatës së Tiranës Nr. [redacted] me adresë Rr. [redacted] Tiranë, me NUIS K41622024G, biznes libri, kuotat e plota të të cilit i zotëroj në mënyrë pasive, duke ia kaluar për administrim bashkëshortit me Akt-marrëveshjen Nr. [redacted] Rep dhe Nr. [redacted] Kol, më datë 27.07.2021.	Vlera fillestare 100000 (Njëqind mijë) lekë	100 %

\* Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar:

- pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
- vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

*[Signature]*



**DEKLARIMI I PASURIVE  
DHE  
BURIMI I KRIJIMIT**

**Objekti i deklarimit:** Të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite deri në datën e fillimit të detyrës, sipas gërmës a, b, c, ç, d \* të nenit 4 dhe nenit 4/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil, të ndodhura brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të zotëruara nga zyrtari, apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë.

**Përshkruani hollësisht:** llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloji pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
5.	Llogari personale bankare në [redacted] bank, Dega Tiranë, me Nr. Klienti [redacted]	<b>1079168,79 Lekë</b> (Një milion e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë lekë e shtatëdhjetë e nëntë qindarka) Dhe <b>812,86 Euro</b> (Tetëqind e dymbëdhjetë Euro e tetëdhjetë e gjashtë Cent)	100 %
6.	Depozitë dvemërore me bashkëshortin në bankën holandeze [redacted] dega [redacted] The Netherlands	<b>1411,19 Euro</b> (Një mijë e katërqind e njëmbëdhjetë Euro e nëntëmbëdhjetë Cent)	50 %

\* Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 lekë**;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash** jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

*[Signature]*

**ANGAZHIME NË VEPRIMTARI  
PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE  
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE**

**Objekti i deklarimit:** Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; të subjektit, bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore, për periudhën nga data 1 Janar deri në datën e fillimit të punës së vitit të deklarimit.

**Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit nga 1 Janari deri datën e fillimit të detyrës.**

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)
Të ardhura nga veprimtaria private si Administratore e Skanderbeg Books.	1200000 Lekë (Një milion e dyqind mijë lekë)
Të ardhura nga honorari si autore për publikimin e veprës “Lutje dimri” nga kontrata me Shtëpinë Botuese Toena, derdhur në bankë më datë 06.05.2021	42500 Lekë (Dyzet e dy mijë e pesëqind Lekë)

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues**

*Flutura Hoxha*

*Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.*



**DETYRIMET FINANCIARE  
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e fillimit në detyrë të subjektit deklarues.


Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve subjekti deklarues ka detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr. 7, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

**Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare shumën e kredisë (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin)dhe këstin mujor.**

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të detyrës (me shifra dhe me fjalë)

*Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.*

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE  
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: [www.hidaa.gov.al](http://www.hidaa.gov.al), E-mail: [info@hidaa.gov.al](mailto:info@hidaa.gov.al)

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE  
E PERSONIT TË LIDHUR

Nr. Indeksi  
në ILDKPKI

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

A U T O R I Z I M  
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE

Në bazë të nenit 9/1, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar,

Autorizoj:

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasi: Richard Wilhelmus Jozef Willem van den Brink bashkëshorti   
Emër Atësi Mbiemër

i/e Subjektit: Flutura Abdurrahman Açka  
Emër Atësi Mbiemër

Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:

Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim

*Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.*

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

Richard van den Brink



**DEKLARIMI I PASURIVE  
DHE  
BURIMI I KRIJIMIT**

**Objekti i deklaramit:** Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në datën e fillimit të detyrës, sipas gërmës a, b, c, ç, d \* të nenit 4 dhe nenit 4/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil, të ndodhura brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të zotëruara nga personi i lidhur me subjektin deklarues.

**Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë të shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie\*, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.**

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
1.	Apartament banimi me sipërfaqe 78 m <sup>2</sup> , në adresën [redacted] The Netherlands. Në pronësi timen dhe sipas ligjeve holandeze me të drejtë të gjysmëpronësisë edhe bashkëshortja ime. Blerë me kredi të vitit 1977, kredi e shlyer prej vitesh.	220000 Euro (Dyqind e njëzet mijë Euro)	50%
2.	Apartament banimi, me sipërfaqe 106 m <sup>2</sup> , në adresën Rr. [redacted] Tiranë. Në pronësi bashkë me bashkëshorten. Blerë me kontratë sipërmarrjeje Nr. [redacted] Rep dhe Nr. [redacted] Kol., dt. 02.05.2002, nga Shoqëria ndërtuese [redacted] Blerë me kredi të marrë nga [redacted] Bank, Dega [redacted] The Netherlands, datë 14.04.2002.	45000 USD (Dyzet e pesë mijë dollarë)	50%
3.	Llogari personale bankare në formë rrjedhëse dhe si depozitë në bankën holandeze [redacted] dega [redacted]	733,49 Euro në llogari rrjedhëse (Shtatëqind e tridhjetë e tre Euro e dyzet e nëntë Cent) 1501 Euro në depozitë (Një mijë e pesëqind e një Euro)	100 %
4.	Depozitë dyemërore me bashkëshorten në bankën holandeze [redacted] dega [redacted] The Netherlands.	1411,19 Euro (Një mijë e katërqind e njëmbëdhjetë Euro e nëntëmbëdhjetë Cent)	50%

5. Biznesin personal, "Skanderbeg Books & webpublishing", i regjistruar 0 Euro (zeroEuro) 100% në Kamer Koophandel (Dhoma e Tregtisë), me numrin 30166770 dhe titullin Eenmanszaak (Biznes i një personi)

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

Richard van der Brink



**ANGAZHIME DHE VEPRIMTARI  
PRIVATE DHE/OSE PUBLIKE  
DHE TË ARDHURAT E KRIJUARA PREJ TYRE**

- Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data 1 Janar deri në datën e fillimit të detyrës të subjektit deklarues.

Përshkruani hollësisht çdo lloj angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura, emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit nga 1 Janari deri datën e fillimit të detyrës së subjektit.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave neto të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)
Të ardhura nga pesioni	21755,36 Euro (Njëzet e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë Euro e tridhjetë e gjashtë Cent)

**DETYRIMET FINANCIARE  
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.,) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e fillimit të detyrës të subjektit deklarues.
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve personi i lidhur ka detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr. 11, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë, për kreditë bankare shumën e kredisë (principalin), kohëzgjatjen (muajin/vitin) dhe këstin mujor, si dhe dokumentat shoqërues që disponohen.

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të detyrës së subjektit (me shifra dhe me fjalë)
Shuma e mbetur për t'u shlyer nga kredia bankare e marrë më datë 14.04.2002 nga [REDACTED] Bank, dega [REDACTED] The Netherlands, për blerje apartamenti në Tiranë. Data e fundit e pagesës së kredisë 01.10.2022. Pagesa e këstit mujor është 418 (Katërqind e tetëmbëdhjetë Euro).	2629 Euro (Dymijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë Euro)

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

*Richard van de Bunt*



## Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave private, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;

- Ligj nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.
- Ligj nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

### Deklarimi i interesave private nga zyrtari (subjekti deklarues)

- Dokumenti zyrtar “**Deklaratë e interesave private para fillimit të detyrës**” duhet të plotësohet nga zyrtari që fillon punë në një nga funksionet që mbart detyrimin për deklarim, por edhe në rastet kur zyrtari ka patur ndërprerje për më tepër se një vit nga funksioni i mëparshëm (nga deklarimi i fundit Pas Largimit).
- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare.
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes, bashkëjetuesit/es është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, bashkëjetuesit/es me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- Formulari i deklarimit plotësohet në mënyrë elektronike, por në çdo rast nënshkruhet me shkrim.
- Subjekti/zyrtari nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave private të personave të lidhur.
- Deklarata duhet të plotësohet dhe dorëzohet, jo më vonë se 30 ditë, nga data e fillimit të detyrës.

### Deklarimi i interesave private nga personi i lidhur me zyrtarin (subjekti deklarues)

- Dokumenti zyrtar “**Deklaratë e interesave private e personit të lidhur**” duhet të plotësohet nga pjesëtarë të familjes (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, për pasuritë që disponojnë veçmas.
- Personi i lidhur me zyrtarin, (*bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore*), i cili mbart detyrimin për deklarim të interesave private në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 8-11.
- Në çdo rast, personi i lidhur është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës, **AUTORIZIMI** ku deklaron nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.

**Kujdes:** Të gjithë zyrtarët dhe personat e lidhur me ta (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore), të cilët bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklarimin për herë të parë, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion Lekë, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI.

Bashkëlidhur Deklarimit të interesave private zyrtari duhet të dorëzojë: kopje të letërnjoftimit (kartës së identitetit) për vete, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore.

Për fëmijët e tjerë zyrtari duhet të dorëzojë fotokopje të pasaportës ose të çertifikatës personale.

Mosplotësimi i këtij detyrimi passjell mospranimin e deklaratës së interesave nga ILDKPKI dhe për pasojë ndaj zyrtarit do të aplikohen sanksione për refuzim të deklarimit të interesave private.

### Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
- Për mosdeklarim para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

**Kujdes:** Të gjitha faqet e formularit të deklaratës duhet të nënshkruhen, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.

- Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me Seksionin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse në numrat e telefonit **042 259 461** Free.08009999, [info@hidaa.gov.al](mailto:info@hidaa.gov.al).
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.